



**VENDIM**

***Nr.131 , Datë 31.10.2015***

**PËR  
MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ANKANDIT TË ZYRES SË  
KOORDINUAR TË ANKANDEVE PËR EVROPËN JUGLINDORE (SEE  
CAO) VERSIONI 1.2**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 65 pika 1 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike; nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, i ndryshuar, si dhe rekomandimet nga Sekretariati i Energjisë (Vjenë, Austri) datë 24.08.2015 dhe mbledhjes së 11-të të ECRB-së të vitit 2009 ku rekomandohet që Rregullatorët Kombëtarë ta miratojnë këtë rregullore, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.10.2015, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur dhe të rënë dakort nga (SEE CAO) dhe TSO-të aksionerë të saj, të Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandëve për Europën Juglindore (SEE CAO) Versioni 1.2 dhe relacionin përkatës,

**Konstatohet se:**

- Rregullorja është e hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores (KE) 714/2009 të Parlamentit Evropian. Në cilësinë e vendit anëtar të ECRB-s rekomandohet që rregullatorët Kombëtarë anëtarë të saj, t’a miratojnë këtë rregullore.
- Sekretariati i Energjisë (Vjene, Austri) datë 24.08.2015 dhe mbledhja 11-të e ECRB-së mbajtur me datë 09.07.2009, rekomandon që rregullatorët Kombëtarë t’a miratojnë këtë rregullore.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të miratojë rregullat e ankandit të zyrës së koordinuar të ankandëve për Evropën Juglindore SEE CAO **Versioni 1.2.** (bashkëlidhur në gjuhën origjinale Angleze).

2. Vendimet Nr. 156 datë 01.12.2014 dhe Nr. 14, datë 11.02.2015, të Bordit të ERE, shfuqizohen.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë personat e interesuar për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare në versionin zyrtar në gjuhën angleze dhe në faqen e ERE-s në gjuhën shqipe dhe angleze.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Petrit AHMETI**